



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.23

2005

15 prill

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.178, datë 31.3.2005	Për trajtimin e punonjësve civilë, që dalin të papunë nga reforma në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve, në Durrës..... 869
Vendim i KM nr.183, datë 31.3.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/6 kV, Mamurras..... 870
Vendim i KM nr.185, datë 31.3.2005	Për miratimin e listës së inventarit dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Berat, Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor të këtij rrethi..... 872
Vendim i KM nr.186, datë 31.3.2005	Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për furnizimin e disa spitaleve me pajisje të hemodializës 875
Vendim i KM nr.191, datë 25.3.2005	Për miratimin e metodikës “Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe të jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si edhe elementet që e përbëjnë atë”..... 876
Vendim i KM nr.192, datë 25.3.2005	Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre..... 881

Vendim i KM nr.193, datë 25.3.2005	Për kriteret e pranimi të nënoficerëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	885
Vendim i KM nr.215, datë 7.4.2005	Për një shtesë në numrin e punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore.....	885
Urdhër i Përbashkët nr.13, datë 8.4.2005	Për marrjen e masave për ndalimin e këmbimit ilegal valutor.....	886
Vendim i ERE nr.18, datë 29.3.2005	Për miratimin e Kodit të matjes së energjisë elektrike (Kodi i matjes).....	887
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik, me objekt “Ndërtimi i rrugës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren “18 shtatori” në qytetin e Gjirokastrës”.....	904

VENDIM
Nr.178, datë 31.3.2005

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE CIVILË, QË DALIN TË PAPUNË NGA REFORMA NË
SHTËPINË E PUSHIMIT TË USHTARAKËVE, NË DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8930, datë 25.7.2002 “Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit civilë të shtëpisë së pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe filialit të saj në Sarandë, që dalin të papunë nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të trajtohen, për periudhën nga data 1.3.2005 deri më 31.3.2006, me pagën minimale, në shkallë vendi, ku të përfshihet edhe kontributi i sigurimit shoqëror.

2. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune deri në datën 28.2.2005.

3. Paga të bëhet çdo muaj nga zyrat përkatëse të punësimit, me fondet që, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i shtohen Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Kjo periudhë pagese t’u njihet këtyre punonjësve si periudhë sigurimi, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti apo familjar dhe të shënohet në librezën e punës, pasi të bëhet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore, në përputhje me ligjin.

5. Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 9 800 000 (nëntë milionë e tetëqind mijë) lekësh, ku përfshihet edhe kontributi i sigurimeve shoqërore.

6. Ky fond të sigurohet si më poshtë vijon:

a) 8 300 000 (tetë milionë e treqind mijë) lekë nga të ardhurat e ish-shtëpisë së pushimit të ushtarakëve, Durrës;

b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë nga Ministria e Mbrojtjes.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.3.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.183, datë 31.3.2005

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/6 KV, MAMURRAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/6 kV, Mamurras, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a., Tiranë.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2233,1 m² tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 233 100 (dy milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e investimeve të KESH sh.a., Tiranë, të miratuara për koston vendore për shpronësimet.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të jetë në shumën 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe të përballohet nga KESH sh.a., kërkuesi për shpronësim.
6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit prill 2005 dhe të përfundojë brenda tremujorit të tretë të këtij viti.
7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/6 kV
MAMURRAS”**

**RRETHI: KURBIN
QYTETI: MAMURRAS**

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : **Tokë Bujqësore Arë**

VENDIM

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja Përgjithshme m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	AVNI	RUSTEM	PEPA	Token Arë	1676	438/27/4	2233.1	1000	2.233.100
Totali									2.233.100

Sqarime :

Shpenzime procedurale : 1. Publikime 65.000 (gjashtedhjetepesemije) lekë
2. Shperblim anetareve te komisionit 20.000 (njetetemije) lekë

Vlefte totale e shpronesimit = 2.233.100 + 85.000 = 2.318.100 lekë.

Nr.185, datë 31.3.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT TË ZYRAVE TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR, DEGA BERAT, SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR
TË KËTIJ RRETHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Berat, Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, për zyrën e përmbarimit të këtij rrethi, me sipërfaqe 100 m², përkatësisht sipas formularit nr.1 dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, zyrës së përmbarimit, Berat, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e kësaj prone, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Fatos Nano

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucioni : Pushkëti Qendror: <u>BERAT</u>		Instituti : <u>Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor</u>		Identifikoi: <u>Liljana Kurti</u> (Specialiste ne Sektorin e Kontabilitetit)		Supervizori: <u>Leonora Horanliu</u> (Pergjegjese e Sektorit te Kontabilitetit)		Data: <u>17.12.96</u>		
Bashkia / Komuna: <u>BERAT</u>		Fusha e perdorimit te Prones: <u>Sigurimi i Kujdesit Shendetesor</u>		Aprovi: <u>GJERGJI LEKA</u> (DREKTORI I PERGJITHSHEM)		Supervizori: <u>Leonora Horanliu</u> (Pergjegjese e Sektorit te Kontabilitetit)		Data: <u>17.12.96</u>		
A		B		C		D		E		
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones	Sip. Totale e Prones (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni, per te Cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me perjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdonues Statusi juridik i perdonimit	(Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Drejtoria Rajonale e Sigurimit te Kujdesit Shendetesor Berat. Adresa: Lagja "30 vjetor", ish poliklinika e vjeter, Berat	100 m ²	100 m ²	Blerje e shërbimit farmaceutik mjekësor	Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Tirane	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Berat. Prona eshte kalim kapital nga ish informarjet farmaceutike me urdher te Ministrise se Shendetesise me 1996	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Berat zhvillon aktivitetin ne mjediset e ish poliklinikes se vjeter Berat, te bera kalim kapital me urdher te Ministrise se Shendetesise, Nr. 278, date 17.12.96

Projekti i planimetrike dhe shprehja e zyrave të ish-kishës
 të qytetit të Shkupit
 Detyra investim
 Berat

SH 1:100



Shënimi: 1) Kati dytë - dyshorë e jashtme
 2) Kati i parë - dyshorë e brendshme

Projektant: Inzh. E. Mendonovski
 Nr. 12/10006



Projekti i planimetrike dhe shprehja e zyrave të ish-kishës
 Berat

Berat
 18/11/04

VENDIM
Nr.186, datë 31.3.2005

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR FURNIZIMIN E DISA SPITALEVE ME
PAJISJE TË HEMODIALIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë që, për fondin limit prej 624 040 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e dyzet) eurosh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, përkatësisht me shoqëritë Fresenius Medical Care GmbH, Gjermani, për shumën 329 480 (treqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro dhe Hospal, Srl, Itali, për shumën 294 560 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) euro, për furnizimin e disa spitaleve me pajisje për shërbimin e hemodializës, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, zëri “Shpenzime kapitale”.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Shtojcë: Numri dhe shpërndarja e pajisjeve të hemodializës

I. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

a. Makina hemodialize 8 (tetë) copë

të kompletuara me:

- Makinë
- Kolltuk
- Tavolinë
- Modul monitorimi

b. Dejonizator uji 1 (një) copë

(me kapacitet për dhjetë poste pune)

II. Spitali rajonal Gjirokastrë

a. Makina hemodialize 8 (tetë) copë

të kompletuara me:

- Makinë
- Kolltuk
- Tavolinë
- Modul monitorimi

III. Spitali rajonal Shkodër

a. Makina hemodialize 7 (shtatë) copë

të kompletuara me:

- Makinë
- Kolltuk
- Tavolinë
- Modul monitorimi

b. Dejonizator uji 1 (një) copë

(me kapacitet për dhjetë poste pune)

IV. Spitali rajonal Elbasan

a. Makina hemodialize 5 (pesë) copë

të kompletuara me:

- Makinë

- Kolltuk

- Tavolinë

- Modul monitorimi

b. Dejonizator uji 1 (një) copë

(me kapacitet për dhjetë poste pune)

VENDIM

Nr.191, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E METODIKËS “PËR MËNYRAT E LLOGARITJES SË NIVELIT TË KËRKUAR TË AFTËSISË PAGUESE PËR SIGURIMIN E JETËS DHE TË JO-JETËS TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT, SI EDHE ELEMENTET QË E PËRBËJNË ATË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 97 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodikës “Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe të jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si edhe elementet që e përbëjnë atë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve të kontrollojë zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

METODIKA

“MBI MËNYRAT E LLOGARITJES SË NIVELIT TË KËRKUAR TË AFTËSISË PAGUESE PËR SIGURIMIN E JETËS DHE TË JO-JETËS TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT, SI EDHE ELEMENTET QË E PËRBËJNË ATË”

1. Metodatat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit janë si më poshtë:

I. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për shoqërinë e sigurimit që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jo-jetës

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese është vlera më e madhe e përfutur nga llogaritjet me metodën me bazë primet dhe metodën me bazë dëmet si më poshtë:

Llogaritja me bazë primet:

A= (+) Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit në vitin e fundit ushtrimor.

(+) Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim në vitin e fundit ushtrimor.

(-) Taksat dhe tatimet që i zbriten (debitojnë) të ardhurat nga primet e sigurimit të dëmeve (jo-jetës).

Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit: shuma e të ardhurave nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit, pasi janë zbritur shumatat e primeve të sigurimit të arkëtueshme prej më shumë se 90 ditësh nga data 31 dhjetor e vitit ushtrimor.

Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim: shuma e të ardhurave nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, pasi janë zbritur shumatat e primeve të risigurimit të arkëtueshme prej më shumë se 180 ditësh nga data 31 dhjetor e vitit ushtrimor.

a1 = Pjesa e shumës “a” që nuk e tejkalon vlefën e 1 miliard lekëve.

a2 = Pjesa e shumës “a” mbi 1 miliard lekë (a > 1 miliard).

b = Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave, i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës në mes të rreziqeve aktuale dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = Koeficienti i pasigurisë, duke marrë për bazë shumën “a1”, ka vlerën 0.18.

b2 = Koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë për bazë shumën “a2”, ka vlerën 0.16

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura (pa pjesën e risigurimeve)

Raporti i risigurimit: c = -----

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe ato të kaluara në risigurim

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe të kaluara në risigurim: Shuma e pagesave të dëmeve, që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shumatat e shtesave në provigjionet teknike të dëmeve, pa zbritur shumatat e dëmeve dhe shtesave të provigjioneve teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura (pa pjesën e risigurimeve): Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shumatat e shtesave në provigjionet teknike të dëmeve, duke zbritur shumatat e dëmeve dhe shtesave në rezervat teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Nëse c < 0.50, për efekt llogaritjeje, do të merret vlera prej 0.50.

Vlera sipas llogaritjes së parë: (a1xb1 + a2xb2) xc

Llogaritja me bazë dëmet:

A= (+) shumatat e pagesës së dëmeve që lidhen me veprimet e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe të atyre që lidhen me marrjen në risigurim të tre apo shtatë viteve e fundit, duke zbritur pjesën e dëmeve (përgjegjësitë) të kaluara në risigurim.

(+) Rezervat për dëmet në fuqi (të pazgjidhura) deri në fund të periudhës mesatare.

(-) Rezervat për dëmet në fuqi (të pazgjidhura) në fillim të periudhës mesatare.

b = a / 3 ose b = a / 7 në varësi të periudhës mesatare përkatësisht tre dhe shtatë vite.

Periudha mesatare është zakonisht tre vjet, por nëse më shumë se 60% e të ardhurave nga primet e një aktiviteti sigurimesh bashkërisht ose të ndara rezultojnë nga kontrata sigurimi që lidhen me rrezikun e dëmeve të kreditit, ngricave, akullit, stuhive, tërmetit, periudha mesatare do të jetë shtatë vjet.

b_1 = Pjesa e shumës “b” që nuk e kalon shumën 750 milionë lekë.

b_2 = Pjesa e shumës “b” që e kalon shumën 750 milionë lekë.

c = Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e dëmeve, i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe të rrezikut të marrë në konsideratë për llogaritjet.

c_1 = Koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë për bazë shumën “ b_1 ”, ka vlerën 0.26.

c_2 = Koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë për bazë shumën “ b_2 ”, ka vlerën 0.23.

Dëmet(përgjegjësitë) e mbajtura (pa pjesën e risigurimeve)

Raporti i risigurimit $d = \frac{\text{Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe ato të kaluara në risigurim}}{\text{Vlera sipas llogaritjes së dytë: } (b_1 c x_1 + b_2 c x_2) x d}$

Nëse $d < 0.50$, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje është 0.50.

Vlera sipas llogaritjes së dytë: $(b_1 c x_1 + b_2 c x_2) x d$

II. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për shoqërinë e sigurimit që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës

1. Përcaktimi i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës që nuk lidhen me fondet e investimeve.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet të cilat u përkasin klasave të sigurimit të jetës, të ndryshme nga klasa 21 e nenit 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, “Sigurim jete i lidhur me fonde të investimeve”, është shuma e dy rezultateve që përftohen nga llogaritjet me metodën me bazë primet dhe metodën me bazë dëmet si më poshtë:

Llogaritja e parë:

(Për kontratat e sigurimit të jetës, të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me fondet e investimit)

a = Shuma e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pa zbritur provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim.

b = Shuma e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pasi zbritur provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim.

Raporti i risigurimit: $c = b : a$

Në rast se ky raport është më i vogël se 0.85, për efekt llogaritjesh do të merret në konsideratë raporti ($c = 0.85$).

d = Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e përfitimit nga investimet, i cili është vlera maksimale e diferencës midis llogaritjeve dhe përfitimit aktual në investime, kjo vlerë është e barabartë me 0.04.

Vlera sipas llogaritjes së parë : $a x c x d$

Llogaritja e dytë:

a_1 = Totali jonegativ, vlera totale e kapitalit të rrezikuar për kontratat individuale të sigurimit të jetës (duke mos zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim), të cilit i zbritet totali i vlerës së kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet);

a_2 = Totali jonegativ i vlerës së kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, për një periudhë mbi tre vjet, por jo më shumë se pesë vjet (që nuk i është zbritur pjesa e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i takon pjesës në risigurim);

a_3 = Totali jonegativ, total i shumave të kapitaleve të rrezikuara për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër që nuk e kalojnë periudhën prej tre vjetësh (duke mos zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së kaluar në risigurim);

b_1 = Totali jonegativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat individuale të sigurimit të jetës (duke zbritur pjesën e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i takon pjesës së dhënë në risigurim), të cilit i zbritet totali i vlerës neto të kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet);

b_2 = Totali jonegativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër dhe kontrata e sigurimit të jetës, me një periudhë mbi tre vjet, por jo më shumë se 5 vjet (duke zbritur pjesën e vlerës së kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim);

b_3 = Totali jonegativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, për një periudhë që nuk i kalon tre vjet (duke zbritur vlerën e kapitalit të

rrezikuar që i përket pjesës së kaluar në risigurim).

Vlera e kapitalit të rrezikuar: Shuma e sigurimit që duhet të paguajë shoqëria e sigurimit, në rast vdekje të ndodhur në kohën e përcaktimit të kërkesave për nivelin e kërkuar të marzhit të aftësisë paguese, e reduktuar nga shuma e provigjoneve matematike të krijuara deri në atë datë në lidhje me sigurimin e dhënë. (Kur llogaritet niveli i kërkuar i aftësisë paguese, nuk mund të merret në konsideratë vlera negative e kapitalit të rrezikuar.)

$$\text{Raporti i risigurimit: } c = \frac{(b_1 + b_2 + b_3)}{(a_1 + a_2 + a_3)}$$

Nëse një raport i tillë është më i vogël se 0.50, vlera që do të merret në konsideratë për efekt llogaritjeje do të jetë 0.50.

d1 = Koeficienti i pasigurisë së rrezikut të vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës, me përjashtim të kontratave të sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi 5 vjet). Vlera e tij është 0.003.

d2 = Koeficienti i pasigurisë për rastet e vdekjes në lidhje me kontratat e sigurimit të jetës me afat më të gjatë se tre vjet, por jo më të gjatë se pesë vjet. Vlera e tij është 0.0015.

d3 = Koeficienti i pasigurisë për rrezikun e vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës me afat të shkurtër, afati i të cilave nuk i kalon tre vjet. Vlera e tij është 0.001.

$$e1 = a_1 \times c \times d_1$$

$$e2 = a_2 \times c \times d_2$$

$$e3 = a_3 \times c \times d_3$$

$$\text{Vlera sipas llogaritjes së dytë} = e_1 + e_2 + e_3$$

2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jo-jetës, që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës.

a = (+) Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara në veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit të dëmeve (Jo-jetës) të lidhura me kontratat e sigurimit të jetës në vitin e fundit ushtrimor.

(+) Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara në veprimtaritë e marrjes në risigurim për kontratat e sigurimit të dëmeve që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës.

(-) Taksat dhe tatimet që debitojnë pjesën e primeve që lidhet me rreziqet e sigurimit të dëmeve (jo-jetës) të lidhura me kontratat e sigurimit të jetës.

Të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit: shuma e të ardhurave nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimit, pasi janë zbritur shumat e primeve të sigurimit të arkëtueshme prej më shumë se 90 ditësh nga data 31 dhjetor e vitit ushtrimor.

Të ardhurat nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim: shuma e të ardhurave nga primet e sigurimit, të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, pasi janë zbritur shumat e primeve të risigurimit të arkëtueshme prej më shumë se 180 ditësh nga data 31 dhjetor e vitit ushtrimor.

a1 = Pjesa e shumës “a” që nuk e tejkalon vlefën e 1 miliard lekëve.

a2 = Pjesa e shumës “a” mbi 1 miliard lekë (a > 1 miliard).

b = Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave, i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës në mes të rreziqeve aktuale dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = Koeficienti i pasigurisë, duke marrë për bazë shumën “a1” ka vlerën 0.18.

b2 = Koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë për bazë shumën “a2”, ka vlerën 0.16.

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura pa pjesën e risigurimeve)

$$\text{Raporti i risigurimit } c = \frac{\text{Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe ato të kaluara në risigurim}}{\text{Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe ato të kaluara në risigurim}}$$

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe ato të kaluara në risigurim

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura dhe të kaluara në risigurim: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, pa zbritur shumat e dëmeve dhe shtesave të provigjoneve teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Dëmet (përgjegjësitë) e mbajtura [pa pjesën e risigurimeve]: Shuma e pagesave të dëmeve që rrjedhin nga veprimtaritë e drejtpërdrejta të sigurimeve dhe nga veprimtaritë e marrjes në risigurim, po ashtu dhe shuma e shtesave në provigjonet teknike të dëmeve, duke zbritur shumat e dëmeve dhe

shtesave në rezerva teknike që i takojnë pjesës së risiguruesit.

Nëse $c < 0.50$, për efekt llogaritjeje do të merret vlera prej 0.50.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit të jo-jetës, që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës: $(a_1 \times b_1 + a_2 \times b_2) \times c$

3. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit të jetës të lidhura me fondet e investimeve

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës, të lidhura me fondet e investimeve, është shuma e dy rezultateve që dalin nga llogaritja e parë dhe llogaritja e dytë si më poshtë vijon:

Llogaritja I

a_1 = Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe ato që lidhen me marrjen në risigurim, pa zbritur provigjonet që i përkasin pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve është marrë përsipër nga siguruesi.

a_2 = Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe veprimtaritë e marrjes në risigurim, pa zbritur provigjonet që i përkasin pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve nuk është marrë përsipër nga siguruesi, kur periudha e transaksioneve i kalon pesë vjet dhe shuma e shpenzimeve administrative është fiksuar për më shumë se pesë vjet.

b_1 = Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe veprimtaritë e marrjes në risigurim, pas zbritjes së provigjoneve që i takojnë pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku i investimeve është marrë nga siguruesi.

b_2 = Totali i provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta dhe veprimtaritë në lidhje me risigurimet, pas zbritjes së rezervave që i takojnë pjesës së dhënë në risigurim, ku rreziku nuk është marrë nga siguruesi dhe periudha e transaksionit është më e gjatë se pesë vjet dhe kur shuma e shpenzimeve administrative është përcaktuar për më shumë se pesë vjet.

Raporti i risigurimit: $c = (b_1 + b_2) : (a_1 + a_2)$

Nëse ky raport është më i vogël se 0.85, raporti i risigurimit që do të merret në konsideratë do të jetë 0.85.

d_1, d_2 = Koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e përfitimit nga investimet, i cili është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis interesit të llogaritur dhe atij aktual të investimeve. Vlerat e tyre janë: $d_1 = 0.04$; $d_2 = 0.01$.

Vlera sipas llogaritjes së parë: $(a_1 \times c \times d_1) + (a_2 \times c \times d_2)$

Llogaritja II

Kjo do të llogaritet vetëm për ato kontrata sigurimi ku siguruesi merr përsipër rrezikun e vdekjes.

a) Totali jonegativ, totali i vlerës së kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të lidhura (së cilës nuk i zbritet pjesa e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim).

b) Totali jonegativ, vlera neto e kapitalit të rrezikuar për kontratat e sigurimit të lidhura (së cilës i zbritet pjesa e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim).

Raporti i risigurimit: $c = b : a$

Nëse raporti i risigurimit është më i vogël se 0.50, për efekt llogaritjeje do të merret për bazë në vlerën 0.50.

d = Koeficienti i pasigurisë në rrezikun e vdekjes për kontratat e sigurimit të jetës, me përjashtim të kontratave të sigurimit të jetës me afat të shkurtër (maksimumi pesë vjet). Ky koeficient ka vlerën 0.003.

Vlera sipas llogaritjes së dytë: $a \times c \times d$

Totali i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për aktivitetin e sigurimit të jetës=

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për rreziqet e sigurimit të jetës (I)

+ Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit të jo-jetës, që lidhen me kontratat e sigurimit të jetës (II)

+ Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për kontratat e sigurimit të jetës, që lidhen me fondet e investimeve (III).

2. Elementet që përfshihen në marzhin e aftësisë paguese

Marzhi i aftësisë paguese i korrespondon aktiveve të shoqërisë së sigurimit, të lira nga çdo përgjegjësi e detyrim i parashikuar, duke zbritur elementet e patrupëzuar. Në veçanti, elementet që përfshihen në të janë:

- A.
1. Kapitali aksionar i paguar (derdhur).
 2. Rezervat që nuk u korrespondojnë përgjegjësi të marrjes në sigurim:
 - Rezerva ligjore,
 - Rezerva të lira.
 3. Rezerva e sigurisë, që nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave të sigurimit në fuqi ose atyre që kanë qenë në fuqi.
 4. Fitime të mbartura:
 - Të mbartura nga vitet e mëparshme,
 - Fitime të pashpërndara për vitin ushtrimor.
 5. Me kërkesën e shoqërisë së sigurimit dhe paraqitjen prej saj të provave të mjaftueshme, rezervat (plus vlerat) e fshehura që rrjedhin nga nënvlerësimi i aktiveve, për aq sa këto rezerva (plus vlera) të fshehura nuk kanë natyrë jo të zakonshme.
 6. Vlera e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara sipas bilancit:
Totali A=1 +2+3+4+5—6
- B.
7. Rezerva që rezultojnë nga rivlerësimi i aktiveve:
Totali B
Totali = Totali A + Totali B

VENDIM
Nr.192, datë 25.3.2005

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT TË AGJENTËVE NË SIGURIME, SI
DHE RREGULLAT PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 77 pikat 9 e 10, dhe 81 pika 2 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjent, në kuptim të nenit 77 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, është personi fizik i licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe i autorizuar nga shoqëria e sigurimit për të kryer veprimtari ndërmjetësimi në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.
2. Shoqëria e agjentëve themelohet nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, si shoqëri anonime, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, dhe veprimtaria e ndërmjetësimit ushtrohet në emër të shoqërisë nga agjentë të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.
3. Veprimtarinë e agjentit në sigurime mund ta ushtrojnë edhe persona fizikë ose juridikë, që kryejnë veprimtari në fushën e shërbimeve, me kusht që veprimtaria e agjentit në sigurime të ushtrohet në emër të tyre, nga agjentë të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.
4. Me veprimtari në fushën e shërbimeve, në kuptim të pikës 3 të këtij vendimi, kuptohen:
 - a) veprimtaria bankare;
 - b) veprimtari shërbimi të agjencive të udhëtimit;
 - c) veprimtari shërbimi të agjencive imobiliare;
 - ç) veprimtari shërbimi të zyrave të këmbimit valutor;
 - d) veprimtari shërbimi postar;
 - dh) veprimtari shërbimi të automjeteve;
 - e) veprimtari shërbimesh financiare.
5. Agjenti ose shoqëria e agjentëve në sigurime kryen veprimtarinë e ndërmjetësimit, në përputhje me ligjin nr.9267, datë 29.7.2004, me legjislacionin për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.
6. Agjenti ose shoqëria e agjentëve në sigurime e ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit vetëm

në emër të një shoqërie sigurimi, me përjashtim të rastit kur, në kontratën e lidhur ndërmjet tyre dhe shoqërisë së sigurimit, parashikohet ndryshe. Komisioni që agjenti përfiton nga shoqëria e sigurimit, nuk mund të jetë më shumë se 10 për qind e primit të rrezikut, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm.

7. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve licencon agjentin e sigurimeve, nëse ai plotëson këto kritere:

A. Kriteret e besueshmërisë:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të ketë vërtetim të gjendjes gjyqësore, si i padënuar;
- c) Të mos jetë debitor në organet tatimore;
- ç) Të mos jetë debitor ndaj shoqërive të sigurimit;
- d) Të mos jetë i punësuar në një shoqëri sigurimi;
- dh) Të ketë në zotërim mjedise të përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime;

e) Të ketë një depozitë bankare prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh në njërin nga bankat e nivelit të dytë, që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të shoqërisë së sigurimit, me të cilën do të lidhë kontratën e agjentit;

ë) Të ketë policë sigurimi për përgjegjësinë profesionale, me minimum mbulimi 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për një periudhë 1-vjeçare.

B. Kriteret e aftësisë profesionale:

- a) Të ketë kryer arsimin e mesëm;
- b) Të ketë garanci profesionale, të vërtetuar me një dokument për kryerjen e një kualifikimi, pranë një instituti trajnimi në sigurime, brenda ose jashtë vendit, me një program të njohur nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve. Nëse aplikanti nuk e ka këtë dokument, ai duhet të paraqesë programin e trajnimit, së bashku me rezultatet e testeve, dhe Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve gjykon përshtatshmërinë ose jo të këtij programi;

c) Të zotërojnë dokumentin e njohurive bazë në përdorimin e kompjuterit.

8. Agjenti, pasi është pajisur me licencë nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, regjistrohet pranë organeve tatimore për të filluar ushtrimin e veprimtarisë.

9. Shoqëria e agentëve, për pajisjen me licencë, depoziton në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin e regjistrimit në gjykatë si shoqëri anonime, së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë;
- b) Vërtetimin e regjistrimit pranë organeve tatimore;
- c) Dokumentet që vërtetojnë se ka punësuar agjentë të pajisur me licencë profesionale;
- ç) Vërtetimin se ka një depozitë bankare prej 300 000 (treqind mijë) lekësh në njërin nga bankat e nivelit të dytë, që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të shoqërisë së sigurimit, me të cilën do të lidhë kontratën e agjentit.

10. Personi fizik ose juridik, i parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, për të marrë licencën e ushtrimit të veprimtarisë së agjentit, depoziton dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin e regjistrimit në gjykatë dhe statutin e shoqërisë;
- b) Vërtetimin e regjistrimit pranë organeve tatimore;
- c) Vërtetimin se nuk është debitor në organet tatimore;
- ç) Dokumentet që vërtetojnë se ka punësuar agjentë të pajisur me licencë.

11. Shoqëria e huaj e agentëve, që kërkon të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet degës së saj, duhet të paraqesë në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve:

- a) miratimin zyrtar për hapjen e degës së saj, të lëshuar nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës;
- b) çdo të dhënë tjetër, të parashikuar në këtë vendim dhe të kërkuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.

12. Për pajisjen me licencë, agjenti paguan, për llogari të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, një komision. Vlera e këtij komisioni dhe e komisioneve për dhënie dhe rinovim licencash, për autorizime dhe miratime përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Komisioni paguhet në çastin e tërheqjes së licencës dhe sa herë që ajo rinovohet.

13. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime rinovohet çdo 3 vjet, në bazë

të kërkesës me shkrim të agjentit, nëse nuk ka ndryshime të kritereve të besueshmërisë dhe atyre profesionale, të përcaktuara në këtë vendim.

14. Aplikantët, të cilët kërkojnë të licencohen për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, paraqesin kërkesë me shkrim pranë Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe këtij vendimi.

15. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për licencim, jep ose refuzon licencën për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime.

16. Kontrolli i dokumentacionit kryhet nga një komision i posaçëm, i cili është përgjegjës për organizimin e procesit të licencimit dhe mbajtjen e evidencave për këtë proces. Komisioni i posaçëm përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe një sekretar, të cilët emërohen nga drejtori ekzekutiv i këtij autoriteti dhe janë punonjës të autoritetit.

17. Lista e agjentëve të licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve botohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e dhënies së licencës, për 3 ditë radhazi, në tri gazeta me qarkullim kombëtar.

18. Çdo agjent duhet të pajiset me dokument identifikimi nga shoqëria e sigurimit, ku shënohen emri, mbiemri i agjentit, si dhe emërtimi i shoqërisë së sigurimit për llogari të së cilës ai punon.

19. Mbikëqyrja e agjentëve në sigurime kryhet nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit dhe kontrollit në vend.

20. Agjenti duhet të ketë të instaluar sistemin e informatizimit (on-line) për raportimin e të dhënave Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe shoqërisë së sigurimit, për llogari të së cilës ai punon.

21. Agjenti është i detyruar të mbajë dokumentacion për veprimtarinë që ushtron, sipas kërkesave të këtij vendimi, dhe ta paraqesë atë gjatë kontrollit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

22. Shoqëria e sigurimit mban regjistër të agjentëve, me të cilët ka lidhur kontratë për kryerjen e shërbimit të agjentit dhe, nëse ka ndryshime, njofton Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve, brenda 15 ditëve.

23. Agjenti në sigurime detyrohet të mbajë evidenca për furnizimin me polica sigurimi nga dega e shoqërisë së sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, kategorive dhe numrave të serive përkatëse.

24. Agjenti kryen aktrakordin e policave të shitura, të cilave u bashkëlidhet mandati i bankës, me degën e shoqërisë së sigurimit, 1 herë në javë, ndërsa dega e shoqërisë së sigurimit bën aktrakordin me drejtorinë e përgjithshme të saj, 1 herë në muaj. Aktrakordin mbahet i ndarë për policat e shitura në lekë nga ato të shitura në valutë dhe përmban:

- a) Llojet e kontratave të shitura të sigurimit;
- b) Numrin e kontratave të shitura;
- c) Primin bruto, të shkruar;
- ç) Numrin e kontratave të anuluar;
- d) Primin e kthyer nga kontratat e anuluar.

25. Agjenti në sigurime detyrohet:

- a) ta ushtrojë veprimtarinë me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj konsumatorëve;
- b) të veprojë me mirëbesim dhe ndjeshmëri për respektimin e të drejtave të konsumatorëve;
- c) të njoftojë të siguarin për produktet e sigurimit, kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të sigurimit, përfitimet, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, si dhe për tarifat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë.

26. Agjenti në sigurime duhet të vërë në dijeni konsumatorin:

- a) për emrin, mbiemrin dhe adresën e vet;
- b) për dokumentin, që vërteton se është i licencuar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime;
- c) se cila nga kontratat e sigurimit plotëson më mirë nevojat e tij.

27. Agjenti në sigurime është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave, të fakteve dhe rrethanave, që kanë të bëjnë me të siguarin, dhe të të dhënave me të cilat njihet gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

28. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve tërheq licencën e dhënë për ushtrim veprimtarie

ndërmjetësimi në sigurime për rastet e parashikuara në nenin 85 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, si dhe për moszbatim të këtij vendimi.

29. Vendimi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për tërheqjen e licencës profesionale mund të ankimohet sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

30. Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj detyrohet që, brenda 3 ditëve nga tërheqja e licencës nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, ta zgjidhë kontratën ndërmjet saj dhe agjentit.

31. Shoqëria e sigurimit kur zgjidh kontratën me një agjent në sigurime, njofton menjëherë Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve.

32. Agjentët e licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, brenda datës 31 korrik 2005, detyrohen të regjistrohen pranë organeve tatimore si persona fizikë ose juridikë dhe të paraqesin në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve vërtetimin për depozitën bankare.

33. Agjentët në sigurime, të licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, detyrohen ta rinovojnë licencën, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, brenda muajit shtator 2005.

34. Vendimi nr.470, datë 3.10.2002 i Këshillit të Ministrave “Për kushtet e dhënies së autorizimit zyrtar dhe rregullat e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.193, datë 25.3.2005

PËR KRITERET E PRANIMIT TË NËNOFICERËVE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 34 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetasi shqiptar, për t’u pranuar nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përveç kushteve të përcaktuara në ligjin nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, duhet të plotësojë, detyrimisht, edhe këto kritere:

a) Të ketë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, për meshkujt, ose të ketë kryer programin e stërvitjes bazë, në qendrën stërvitore Bunavi dhe stërvitjen individuale në shkollën e trupës, për femrat;

b) Të përmbushë format e testimit shëndetësor, fizik dhe intelektual, të miratuara nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

c) Të ketë përfunduar detyrimisht Akademinë e Nënoficerëve “Lodewijk W.J.K.Tomson”, Tiranë ose një akademi ushtarake jashtë vendit, të njësuar me të.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.215, datë 7.4.2005

**PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE
PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të kalimit të sistemit të paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për qarqet Lezhë dhe Shkodër, i shtohen 33 punonjës, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, për vitin 2005.

2. Ministrisë së Rendit Publik, në kuadër të kalimit të sistemit të paraburgimit, për qarqet Lezhë dhe Shkodër, i pakësohen 33 punonjës, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, të miratuar për vitin 2005, përkatësisht, 21 punonjës nga Drejtoria e Policisë së qarkut Lezhë dhe 12 punonjës nga Drejtoria e Policisë së qarkut Shkodër.

3. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 29 975 370 (njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekësh, në zërat si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------|-------------|
| a) Paga | 9 942 900; |
| b) Sigurime shoqërore | 3 052 470; |
| c) Shpenzime operative | 16 980 000. |

4. Ky fond prej 29 975 370 lekësh t’i pakësohet Ministrisë së Rendit Publik, nga buxheti i miratuar për vitin 2005.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

URDHËR
Nr.13, datë 8.4.2005

PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALIMIN E KËMBIMIT ILEGAL VALUTOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 8 pika 9 dhe nenit 13 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 "Për policinë bashkiake e të komunës", të nenit 14 të ligjit nr.8610 datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.8553, datë 21.11.1999 “Për Policinë e Shtetit dhe të nenit 49 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e ushtrimit në mënyrë të paligjshme të tregtimit dhe këmbimit valutor,

URDHËROJMË:

1. Të merren masa për ndalimin e ushimit të këmbimit valutor të palicencuar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi ky aktivitet sjellë shmangie të detyrimeve fiskale, kryerjen e transaksioneve ilegale valutore jashtë sistemit bankar, favorizim të elementeve kriminale për këmbim të parave të rrjedhura nga krimet, mashtrime, grabitje, vjedhje, të klientëve dhe vetë këmbyesve ilegalë, qarkullim të monedhave të falsifikuara dhe ushtrim të aktivitetit të paligjshëm në ambiente publike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Policia Tatimore), policitë bashkiake dhe të komunave të koordinojnë veprimet për parandalimin, ndërprerjen dhe procedimin ligjor, administrativ ose penal të çdo personi që ushtron veprimtarinë e këmbimit të palicencuar valutor në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Përfaqësuesit e grupit teknik ndërinstitucional të punës për parandalimin e pastrimit të parave programojnë dhe të koordinojnë masat ndërmjet institucioneve me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e ushtrimit në mënyrë të paligjshëm të tregtimit dhe këmbimit valutor.

4. Strukturat e përcaktuara në pikën 6 të këtij urdhri të raportojnë në mënyrë periodike te titullarët e institucioneve dhe nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre të informojnë grupin teknik ndërinstitucional të punës për parandalimin e pastrimit të parave.

5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës informon titullarët e institucioneve bashkërenduese dhe kryetarin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

6. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria kundër Krimin të Organizuar në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe policitë bashkiake e të komunave në vend.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR DHE
DECENTRALIZIMIT

Ben BLUSHI

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Igli Toska

DREJTORI I SHËRBIMIT INFORMATIV
SHTETËROR
Bahri Shaqiri

VENDIM

Nr.18, datë 29.3.2005

PËR MIRATIMIN E KODIT TË MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (KODI I MATJES)

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa i, nenit 9 dhe nenit 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Task-Forca, e ngritur për përgatitjen e Kodit të matjes së energjisë elektrike (Kodi i matjes)

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të matjes së energjisë elektrike (Kodi i matjes). (Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

KODI I MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (KMEE)

Ristrukturimi i sektorit të energjisë elektrike dhe liberalizimi i tregut të energjisë elektrike kërkon pa dyshim furnizim, transaksione (shitje-blerje) dhe shkëmbime (marrje-dhënie) të energjisë elektrike midis pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Furnizimi, transaksionet (shitje-blerje) dhe shkëmbimet (marrje-dhënie) e energjisë elektrike duhet të maten dhe të monitorohen në kufijtë ndarës të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike, të shoqëruar me transaksionet financiare mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse.

Të gjitha marrëveshjet, e lidhura për furnizimin, transaksionet (shitje-blerje) dhe shkëmbimet (marrje-dhënie) të energjisë elektrike midis palëve, do të bazohen në termat dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Kodi i matjes së energjisë elektrike–KMEE përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, që do të jetë i përshtatshëm për matjen, mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse, sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe marrëveshjeve midis palëve.

Pajisjet matëse do të sigurohen nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, si dhe të gjitha subjektet juridike apo fizike, që detyrohen nga legjislacioni në fuqi dhe do të jenë të regjistruara në sistemin e regjistrimit të matësve (SRM) dhe në përputhje me termat e KMEE, si dhe në përputhje me ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”.

Kodi i matjes së energjisë elektrike është ndarë në katër pjesë kryesore:

1. Përkufizime dhe shpjegime,
 2. Kërkesa të përgjithshme,
 3. Kërkesa teknike,
 4. Kërkesa teknike për konsumatorët fundorë.
1. Përkufizime dhe shpjegime të termave në KMEE
 - 1.1 Përkufizime të termave

TERMI	PËRKUFIZIMI
Kodi i matjes së energjisë elektrike (KMEE)	KMEE përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, i cili do të jetë i përshtatshëm për matjen, për regjistrimin, mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike, marrëveshjeve midis palëve dhe legjislacionit në fuqi.
Certifikimi i matësit të energjisë elektrike	“Certifikim” kuptohet veprimtaria nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces ose shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit ose në Standarde.
Autorizim	“Autorizim” kuptohet dhënia e së drejtës, për të kryer verifikime dhe kalibrime të mjeteve matëse në sferën e detyrueshme, të subjekteve publike ose private, vendase ose të huaja që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Kalibrim	“Kalibrim” kuptohet seria e veprimeve të kryera në kushte të caktuara, të cilat përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet vlerës së treguar nga mjeti matës dhe vlerës korresponduese të realizuar nga etaloni i matjes.
Verifikim	“Verifikim” kuptohet konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, që kërkesat specifike tekniko-metrologjike janë plotësuar.
Inspektim	“Inspektim” kuptohet shqyrtimi i një produkti matës, shërbimi matës, procesi matës ose sistemi matës dhe përcaktimi i

Energjia elektrike	konformitetit të tyre me kërkesat specifike ose mbi bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.
Energjia elektrike aktive (Wh)	Energjia elektrike kupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive. Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është vat-orë ose shumëfisha të saj: $1000 \text{ Wh} = 1 \text{ kWh}$ $1000 \text{ kWh} = 1 \text{ MWh}$ $1000 \text{ MWh} = 1 \text{ GWh}$ $1000 \text{ GWh} = 1 \text{ TWh} = 10^{12} \text{ Wh}$
Energjia elektrike reaktive (VArh)	Energjia elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufijë kohe i fuqisë reaktive matur në njësi me volt-amper reaktive-orë ose shumëfisha të saj. $1000 \text{ VArh} = 1 \text{ kVArh}$ $1000 \text{ kVArh} = 1 \text{ MVArh}$ $1000 \text{ MVArh} = 1 \text{ GVArh}$ $1000 \text{ GVArh} = 1 \text{ TVArh} = 10^{12} \text{ VArh}$
Fuqia elektrike aktive (W)	Fuqia elektrike aktive është produkti i tensionit dhe i rrymës dhe kosinusit të këndit ndërmjet tyre. $P = (U \times I) \times \cos\phi$ Matet me njësinë Vat (W) ose shumëfisha të saj: $1000 \text{ W} = 1 \text{ kW}$ $1000 \text{ kW} = 1 \text{ MW}$ $1000 \text{ MW} = 1 \text{ GW}$ $1000 \text{ GW} = 1 \text{ TW} = 10^{12} \text{ W}$
Fuqia elektrike reaktive (VAr)	Fuqia elektrike reaktive është produkti i tensionit dhe i rrymës dhe sinusit të këndit të fazës ndërmjet tyre. $Q = (U \times I) \times \sin\phi$, matet me njësinë volt-amper reaktiv (VAr) ose shumëfisha të saj: $1000 \text{ Var} = 1 \text{ kVAr}$ $1000 \text{ kVAr} = 1 \text{ MVar}$ $1000 \text{ MVar} = 1 \text{ GVar}$ $1000 \text{ GVar} = 1 \text{ TVAr} = 10^{12} \text{ VAr}$
Eksport - Import	Eksport-Import quhet lëvizja e fluksit të energjisë elektrike nga impiante ose instalime elektrike të një vendi, në impiante ose instalime elektrike të një vendi tjetër.
ERE	ERE–Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike
Prodhuesit (Gjeneruesit)	“Prodhuesi (Gjeneruesi)” kuptohet një person i licencuar për të prodhuar energji elektrike.
Operatori i sistemit të transmetimit	“Operatori i sistemit të transmetimit” kupton subjektin e licencuar, i cili është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit.
Kompanitë e shpërndarjes	“Kompani të shpërndarjes” kupton personin e licencuar dhe përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.
Klient i kualifikuar	Një konsumator i energjisë elektrike që ka të drejtë sipas legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të miratuara nga ERE, të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike për energjinë elektrike të përdorur për nevojat e tij.
Furnizuesi	Person i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit në fuqi.
Furnizuesi i kualifikuar	“Furnizues i kualifikuar” kuptohet personi i licencuar për të furnizuar me energji elektrike klientët e kualifikuar.
Përdorues	Persona që kryejnë veprimtari të licensuara në sistemin elektroenergetik, si prodhuesit (gjeneruesit), shpërndarësit

	(kompanitë e shpërndarjes), klientët e kualifikuar, furnizuesit, si dhe çdo person juridik që përfiton nga shërbimet e sistemit të transmetimit.
Konsumatori fundor	Një person që blen energji elektrike për të konsumuar për nevojat e tij.
Ditë-pune	Ditë-pune kuptohet çdo ditë, përveç të shtunës, të dielës dhe ditëve festë zyrtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Kërkesa maksimale për energji elektrike	Kërkesa maksimale është vlera më e lartë e kërkesës për energji elektrike e regjistruar në një kohë të caktuar për të përcaktuar tarifat ose për qëllime të tjera.
Legjislacion	Legjislacion do të thotë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
IEC	International Electrotechnic Commity (Komiteti Elektroteknik Ndërkombëtar)
Matës	“Matës” kuptohet një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike.
Matja	“Matje” kuptohet seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.
Komisioni i Kodit të matjes së energjisë elektrike (KKMEE)	Komisioni i Kodit të matjes së energjisë elektrike (KKMEE) është një komision i ngritur ku përfaqësohen pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, funksionet e këtij komisioni përcaktohen në këtë Kod.
Marrëveshja e tregut	Marrëveshja e tregut kupton një marrëveshje, e cila përmban rregullat e tregtisë dhe përgjegjësitë e palëve në marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi.
Pika e matjes	Pika e matjes është vendi fizik, ku është realizuar pika e lidhjes dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë, sipas këtij Kodi. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet ndërmjet palëve.
Pika e lidhjes	Pika e lidhjes është vendi fizik ku realizohet lidhja e përdoruesit/konsumatorit me sistemin e transmetimit/sistemin e shpërndarjes.
Personi	Personi kupton çdo person fizik ose juridik.
Matës kontrolli	Matësi i kontrollit quhet matësi i certifikuar dhe i autorizuar për kontrollin e matjes, në raste kur ka mosmarrëveshje ndërmjet Palëve për tregimet e matjes së matësit të vendosur në objekt ose në rastin e kontrolleve rutinë të programuara të matësve.
Përputhja e matjes	Përputhja e matjes kupton krahasimin e vlerës së energjisë elektrike të regjistruar në matës me vlerën e energjisë elektrike e regjistruar në distancë.
Sistemi i matjes së energjisë elektrike	Sistemi i matjes së energjisë elektrike kupton tërësinë e pajisjeve të matjes: matësin, automatin, transformatorët e matjes, mbrojtjen e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në objekt.
Periudha e marrëveshjes	Periudha e marrëveshjes kupton kohën gjatë të cilës përmbushen detyrimet kontraktuale të energjisë elektrike sipas marrëveshjes tregtare midis personave apo palëve.
Rryma e matjes	Rryma e matjes kupton rrymën e lejuar të matësit të përdorur me qëllim matje.
Regjistruues lokal	Regjistruesi lokal kupton një pajisje shoqëruese, regjistruese dhe

	memorizuese të aparatit matës ose një kompjuter portativ, që mund të marrë të dhënat e matjes së energjisë elektrike aktive, reaktive, (si dhe të dhëna të tjera), t'i ruajë ato dhe t'i riprodhojë në një vend dhe në një kohë tjetër.
Sistemi i të dhënave	Sistemi i të dhënave kupton një sistem të integruar që mbledh dhe merr të dhënat prej pajisjeve të matjes (matësit) mbi bazën e një teknologjie të caktuar komunikimi dhe programi aplikativ.
Sistemi i regjistrimit të matësit (SRM)	Sistemi i regjistrimit të matësit (SRM) kupton një sistem, i cili identifikon matësin dhe konsumatorin që i takon dhe përmban të dhënat kryesore të matësit në përputhje me KMEE.
Sistemi i transmetimit	Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përbëhet nga bashkësi linjash elektrike të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400kV), stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilëve përfshin transmetimin ose interkoneksionin ndërkombëtar. Çdo aset që përfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, shërbimet ndihmëse, truallin, ndërtesat dhe asete të tjera ndihmëse, elektrike ose jo, të cilat nevojiten për funksionimin e duhur të instalimeve të veçanta të sistemit të transmetimit, janë elemente përbërëse të sistemit të transmetimit.
Sistemi i shpërndarjes	Sistemi i shpërndarjes përfshin gjithë elementet në nivelet e tensionit poshtë 110 kV, të cilat zotërohen nga kompanitë shpërndarëse.

1.2 Shpjegime

Disa nga shpjegimet kryesore të KMEE-së kuptohen si më poshtë:

- a) Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, termi “inspektor” do të nënkuptojë çdo individ ose çdo subjekt, i cili quhet i tillë në bazë të legjislacionit në fuqi;
- b) Çdo referencë në legjislacionin në fuqi, në rregulloret, direktivat, udhëzimet, kodet do të përfshijë, gjithashtu edhe të gjitha amendamentet, shtojcat, modifikimet dhe zëvendësimet përkatëse që mund të jenë bërë;

Referenca në termin “me shkrim” përfshin çdo formë të shkrimit të fjalëve dhe shtypjen e tyre në një formë të ligjshme.

2. Kërkesa të Përgjithshme

2.1 Qëllimi

KMEE përmban normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike, me qëllim tregtimin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sipas marrëveshjeve të vendosura për eksportin dhe importin, energjia elektrike (MWh dhe MVArh), e eksportuar dhe e importuar në çdo pikë matjeje duhet të matet dhe të regjistrohet me anën e pajisjeve matëse të instaluar dhe të mirëmbajtura sipas kushteve të KMEE-së.

KMEE do të zbatohet nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike:

1. Të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike.
2. OST sh.a.;
3. Kompania(të) e shpërndarjes;
4. Furnizuesit;
5. Furnizuesit e kualifikuar vendas ose të huaj;
6. Klientët e kualifikuar;
7. Klientët tariforë (vetëm në kuptimin e zbatimit të këtij Kodi).

2.2 Objekti

KMEE paraqet praktikën që do të përdoret dhe kushtet që do të zbatohen për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Në veçanti, për sistemin e matjes Kodi përcakton dhe specifikon këto kushte kryesore:

- Kërkesat teknike dhe standardet e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të sistemit të matjes;
- Saktësinë dhe kalibrimin;
- Verifikimin e ekzistencës së certifikimit dhe testimit;
- Leximin, regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave të matjes etj.

2.3 Kërkesa të përgjithshme për pajisjet e matjes

2.3.1 Standardet

Sistemet e matjes dhe pjesët përbërëse të saj do të jenë në përputhje me normat e përcaktuara në KMEE, si dhe ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”.

Komisioni i KMEE-së, do të shqyrtojë dhe do të diskutojë çdo normë të re të propozuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me sistemin e matjes dhe do t’ia propozojë për miratim ERE - s.

Në qoftë se pajisjet ekzistuese të sistemit të matjes nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e saktësisë të përshkruara në paragrafët e KMEE-së, palët përkatëse do të bëjnë zëvendësimin e tyre.

Për sistemin e matjes përdoret një protokoll komunikimi i përcaktuar dhe i specifikuar sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike, marrëveshjeve ndërmjet palëve dhe këtij Kodi.

2.3.2. Saktësia e sistemit të matjes

Sistemi i matjes do të jetë me saktësi brenda kufijve të përcaktuar në KMEE, standardet ndërkombëtare, si dhe legjislacionin në fuqi.

Kërkesat e këtij Kodi do të zbatohen njësoj si për matësit kryesorë, ashtu dhe për matësit e kontrollit.

2.4. Verifikimi i ekzistencës së certifikimit dhe testimi i sistemit të matjes

2.4.1 Përgjegjësitë e KSH, furnizuesit, furnizuesit të kualifikuar, OST sh.a. dhe gjeneruesve

Kompania(të) e shpërndarjes (KSH), furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar janë përgjegjës për:
- verifikimin e ekzistencës së certifikimit dhe testimin e sistemit të matjes që zotërohen nga KSH, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar sipas kërkesave të KMEE-së, standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi;

- regjistrimet dhe të dhënat për të gjithë paisjet matëse që lidhen me kalibrimin, si edhe me rezultatet e çdo testi;

Në këto regjistrime mund të përfshihen edhe detaje të tjera të dhënash që do të konsiderohen të pranueshme nga pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Çdo regjistrim duhet të jetë i plotë dhe i saktë sipas parametrave të sistemit të matjes.

- vulosjen e të gjithë sistemit të matjes të KSH, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar të pajisjeve të regjistrimit dhe mbledhjes së të dhënave, si edhe të pajisjeve të komunikimit siç mund të jenë *modem-et* apo lidhjet telefonike.

OST sh.a. është përgjegjës për:

- verifikimin e ekzistencës së certifikimit dhe testimin e sistemit të matjes që zotërohen nga OST sh.a. sipas kërkesave të KMEE, standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi;

- instalimin e sistemit të matjes dhe matësin, të përdoruesve që janë lidhur në sistemin e transmetimit. Këto pajisje duhet të jenë sipas kërkesave dhe normave të këtij Kodi, standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi dhe të jenë të regjistruar në SRM;

- ruajtjen e regjistrimeve dhe të dhënave për të gjithë sistemin e matjes, që lidhet me kalibrimin, si edhe me rezultatet e çdo testi.

Në këto regjistrime mund të përfshihen edhe detaje të tjera të dhënash që do të konsiderohen të pranueshme nga pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Çdo regjistrim duhet të jetë i plotë dhe i saktë sipas parametrave të sistemit të matjes.

Në linjat e interkoneksionit instalohen sisteme matje në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe me OST-në dhe vendeve fqinjë.

Gjeneruesit janë përgjegjës për:

- verifikimin e ekzistencës së certifikimit dhe testimin e sistemit të matjes që zotërohen nga gjeneruesit sipas kërkesave të KMEE-së, standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi;

- instalimin e sistemit të matjes dhe matësin, në sistemet/objektet e tyre;
Këto pajisje duhet të jenë sipas kërkesave dhe normave të këtij Kodi, standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi dhe të jenë të regjistruar në SRM.

- ruajtjen e regjistrimeve dhe të dhënave për të gjithë sistemin e matjes, që lidhet me kalibrimin, si edhe me rezultatet e çdo testi.

Në këto regjistrime mund të përfshihen edhe detaje të tjera të dhënash që do të konsiderohen të pranueshme nga pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Çdo regjistrim duhet të jetë i plotë dhe i saktë sipas parametrave të sistemit të matjes.

2.4.2 Verifikimi i ekzistencës së certifikimit të matësve

Matësit e përdorur në përputhje me këtë Kod do të jenë të certifikuar.

Të gjitha pajisjet e reja të matjes duhet të jenë të certifikuara dhe të kenë kaluar testet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Testet do të kryhen në përputhje me standardet përkatëse IEC të përshkruara në këtë Kod, legjislacionin në fuqi dhe me direktivën e instrumenteve matëse të Këshillit të Europës (KE).

Jetëgjatësia e matësit duhet të jetë e përcaktuar në certifikatën e matësit. Zgjatja e vlefshmërisë së kësaj certifikate mund të jetë e ndryshme për tipe të ndryshme matësish dhe mund të ndryshojë kohë pas kohe.

Për të gjitha sistemet e matjes dhe matësat kërkohet edhe certifikimi i vulës. Vula duhet të mbetet e padëmtuar, në mënyrë që matësi të konsiderohet plotësisht i certifikuar.

Në rast ndërhyrje në sistemin e matjes ose matës, vula ekzistuese duhet të dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme.

Matësit e hequr nga funksionimi duhet të testohen në laboratorët e autorizuar apo të certifikuar përsëri sipas këtij Kodi përpara riinstalimit të tyre për përdorim.

2.4.3. Inspektimi dhe testimi

Të gjithë matësit, transformatorët e rrymës dhe të tensionit dhe pajisjet e tjera të sistemit të matjes do të jenë të testuar për saktësinë e tyre përpara se të vihen në punë. Testimet duhet të bëhen në periudha të caktuara kohore për të kontrolluar dhe verifikuar që funksionimi i matjes është brenda kufijve të lejuar të gabimit të dhënë në KMEE.

Testimi do të realizohet sipas grafikut kohor të paraqitur më poshtë:

Niveli i fuqisë	>50 MVA	10 MVA-50 MVA	1 MVA-10 MVA	<1 MVA
Periudha e testimit	2 vjet	3 vjet	4 vjet	5 vjet

KSH, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar, OST sh.a. dhe gjeneruesit mund t'i ndryshojnë këto periudha kohore, me miratim nga ERE, në bazë të performancës dhe karakteristikave të sistemit të matjes.

Matësi i vendosur në objekt rekomandohet të jetë i pajisur me terminale të testimit, në mënyrë që të ketë mundësi për të punuar në objekt. Këto terminale duhet të jenë afër matësit. Ky rekomandim lihet në gjykimin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve për t'u zbatuar.

Rekomandohet gjithashtu, që nëse matësi i vendosur në objekt nuk është i pajisur me terminale, gjatë periudhës së testimit të tij të zëvendësohet me një matës tjetër të testuar dhe të certifikuar.

Testet do të kryhen në mënyrë të tillë që të gjitha palët të kenë informacion për testet, të jenë të ftuar për të marrë pjesë dhe rezultatet e këtyre testeve të jenë në dispozicion të çdo pale.

Testet duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të minimizohen dhe të shmangen ndërprerjet e matjes së energjisë elektrike ku pajisjet janë instaluar.

Për kryerjen e testeve do të përdoren pajisje të certifikuara të testimit sipas legjislacionit në fuqi dhe standardet përkatëse dhe kur gjykohet e nevojshme (sipas një marrëveshje ndërmjet palëve) mund të përdoren pajisjet dhe kushtet që ofron një laborator i autorizuar sipas ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)".

Në rastin kur një test tregon një gabim që kalon kufijtë e gabimit të përshkruar në këtë kod atëherë gabimi do të regjistrohet përpara riparimit të pajisjes matëse apo të një pjese të saj ose para zëvendësimit të komponentëve me difekt.

2.4.4 Inspektimi dhe testimi në raste të veçanta

Është e pranueshme që për sistemin e matjes, përveç inspektimeve të programuara sipas paragrafit 2.4.3, të kërkojnë të kryhen inspektime të veçanta për sistemin e matjes dhe sistemet e tyre të regjistrimit nga pjesëmarrësit e tregut. Për këto inspektime zbatohen dispozitat e nenit 51 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Matësi duhet të jetë i testuar edhe jashtë kufijve të lejuar të matjes. Në qoftë se mbas testimit midis matësit kryesor dhe atij të kontrollit rezulton një devijim më i madh se 1.5 herë se kufijtë e lejuar të gabimit të përmendur në Kod, atëherë matësi duhet të zëvendësohet ose të riparohet në mënyrë që të përmbushë standardet dhe normat e këtij Kodi.

2.5 Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike

Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike do të garantojnë dhe do të sigurojnë që i gjithë sistemi i të dhënave është mbledhur dhe regjistruar sipas procedurave të përcaktuara në rregullat e tregut të energjisë elektrike si dhe marrëveshjet midis palëve, dhe procedurat për vlefshmërinë, vlerësimin, zëvendësimin dhe bashkimin e këtyre të dhënave janë në përputhje me kërkesat e rregullave të tregut të energjisë elektrike.

2.6 Kushtet për matësit dhe regjistrimi

Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike do të pajisin, instalojnë dhe mirëmbajnë të gjithë matësit dhe sistemet e matjes, të cilët do të jenë të regjistruar në sistemin e regjistrimit të matësve (SRM).

OST sh.a. është përgjegjës për:

- pajisjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e matësit, sistemit të matjes dhe matjen në kufijtë e sistemit të transmetimit dhe te përdoruesit e energjisë elektrike;
- pajisjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të matjes dhe matjen në linjat e interkoneksionit.

Këto sisteme matjeje do të jenë sipas normave të këtij Kodi dhe standardeve ndërkombëtare dhe do të jenë të regjistruar në SRM.

KSH, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar janë përgjegjës për:

- pajisjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e matësit, sistemit të matjes dhe matjen në kufijtë ku konsumatorët janë të lidhur me sistemin e shpërndarjes.

Konsumatorët që lidhen në sistemin e shpërndarjes mund të jenë klientë tariforë dhe klientë të kualifikuar. Përsa u përket klientëve të kualifikuar sistemi i matjes instalohet nga KSH ose furnizuesi i kualifikuar për llogari të klientit të kualifikuar sipas marrëveshjes midis palëve.

Këto sisteme matjeje do të jenë sipas normave të këtij Kodi dhe standardeve ndërkombëtare dhe do të jenë të regjistruar në SRM.

Gjeneruesit janë përgjegjës për:

- pajisjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e matësit, sistemit të matjes dhe matjen në pikën e matjes (pika ku matet energjia elektrike), si dhe për sistemet e matjes të instaluara në sistemet/objektet e tyre.

Këto sisteme matjeje do të jenë sipas normave të këtij Kodi e standardeve ndërkombëtare dhe do të jenë të regjistruara në SRM.

Të dhënat në SRM do të jenë konfidenciale dhe do të administrohen nga pala përkatëse në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

SRM do të përmbajë të paktën këto specifikime për sistemet e matjes dhe matësit për çdo pikë matje:

- Specifikimet teknike të matësit;
- Numrin serial;
- Numrin e thirrjes (kontrollin në distancë);
- Vlerën e impulseve matëse;
- Të dhëna të transformatorëve të matjes (transformatorë rryme, transformatorë tensioni);
- Certifikatat e pajisjeve të sistemit të matjes (për ato që janë);
- Pikën e lidhjes/adresën e objektit ku është lidhur matësi i klientit;
- Numri ID (identifikues) i konsumatorit;
- Numri ID (identifikues) i furnizuesit;
- Data e instalimit;

- Testet e instalimit;
- Teste të ndryshme siç mund të kërkojnë.

SRM do të ketë të regjistruar deri në ditën aktuale çdo ndryshim të përdoruesve dhe konsumatorëve, pajisjeve matëse dhe çdo shprehje të lidhjeve të tyre. Çdo informacion tjetër, në lidhje me çdo pikë matjeje që mund të kërkojë nga pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike, duhet të jetë i regjistruar në SRM.

SRM do të ruajë informacionin që kërkojë në këtë paragraf për një periudhë kohore minimumi 10 vjet për çdo pikë matjeje.

Të dhënat e SRM do të jenë të vlefshme për subjektet apo personat fizikë e juridikë sipas kërkesës së tyre dhe sipas formatit të përcaktuar nga KKMEE.

2.7 Menaxhimi i të dhënave të matjes

2.7.1 Regjistrimi i të dhënave të matjes

Të dhënat në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të eksportuar dhe të importuar nga çdo pjesëmarrës i tregut regjistrohen, vlerësohen dhe përpunohen sipas kërkesave të këtij Kodi. Vlerësimi dhe rifreskimi i të dhënave do të bëhet edhe sipas përcaktimeve në marrëveshjet midis palëve.

OST sh.a. do të regjistrojë leximin e të dhënave të matjes për:

- të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit duke përfshirë prodhuesit, kompaninë(të) shpërndarëse, konsumatorët e lidhur direkt në rrjetin e transmetimit, si dhe furnizuesit dhe klientët e kualifikuar;

- linjat e interkoneksionit.

Prodhuesit do të regjistrojnë të dhënat e matjes në pikën e tyre të lidhjes.

KSH do të regjistrojnë të dhënat e matjes për:

- Klientët tariforë;

- Prodhuesit e lidhur në sistemin e shpërndarjes;

- Furnizuesit dhe konsumatorët e kualifikuar që përdorin sistemin e shpërndarjes.

Furnizuesit do të regjistrojnë të dhënat e matjes përkatësisht në pikën/pikat përkatëse të shitjes/blerjes së energjisë elektrike.

Furnizuesit e kualifikuar dhe klientët e kualifikuar do të regjistrojnë të dhënat e matjes në pikën e lidhjes së tyre sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

2.7.2. Mënyra e regjistrimit të të dhënave të matjes

Në përgjithësi sistemet e regjistrimit e të dhënave të matjes rekomandohet të kontrollojnë në distancë sistemin e matjes dhe t'i marrin të dhënat në intervale të caktuara kohore. Intervali kohor i marrjes së të dhënave përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Përveç kontrollit dhe marrjes së të dhënave në distancë duhet të parashikohet që të ketë mundësi për marrjen e të dhënave në mënyrë manuale nga regjistruesit lokalë. Në rastin e klientëve fundorë në përgjithësi dhe klientëve tariforë në veçanti, regjistrimi i të dhënave të matjes të bëhet me leximin direkt nga matësi.

Kontrolli në distancë do të realizohet me anën e mjeteve të mëposhtme të komunikimit:

- rrjetit telefonik ekzistues;

- linjave të dedikuara të telekomunikacionit;

- lidhjeve me anën e fibrave optike;

- radiove rele;

- sistemit GSM;

- sisteme të tjera të përshtatshme komunikimi.

duke përdorur protokolle sipas standardeve ndërkombëtare dhe të rëna dakord në marrëveshjet midis palëve.

Për çdo sistem të matjes, nga matësi do të merren të dhënat si më poshtë:

Për klientët tariforë:	Energjia elektrike aktive
- për lidhje në TU:	Energjia elektrike aktive
- për lidhje në TM :	Energjia elektrike reaktive
Për klientët e kualifikuar:	Energjia elektrike aktive Energjia elektrike reaktive Fuqia elektrike aktive Fuqia elektrike reaktive $\cos\varphi$ Parametra të tjerë që do të vendosen me marrëveshje midis palëve.
Për prodhuesit:	Energjia elektrike aktive Energjia elektrike reaktive Fuqia elektrike aktive Fuqia elektrike reaktive
Për OST-sh.a.:	Energjia elektrike aktive Energjia elektrike reaktive Fuqia elektrike aktive Fuqia elektrike reaktive $\cos\varphi$
Kompaninë(të) shpërndarëse, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar:	
Për çdo fidër në TM (35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV):	Energjia elektrike aktive Energjia elektrike reaktive
Për çdo kabinë TM/TU: (matja në TU)	Energjia elektrike aktive Energjia elektrike reaktive

Parametrat e paraqitur më lart janë kërkesat minimale, palët me marrëveshje mund të vendosin marrjen e parametrave të tjerë.

2.7.3. Matja dhe përpunimi i të dhënave

Sistemi i matjes duhet të jetë i mbrojtur teknikisht nga ndërhyrjet lokale dhe ato në distancë.

Parametrat e përmendur në këtë Kod duhen regjistruar dhe ruajtur në përputhje me normat e paraqitura në paragrafët e këtij Kodi, si dhe në marrëveshjen midis palëve.

Kompania(të) e shpërndarjes, furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar duhet të instalojnë programe kompjuterike, të cilat realizojnë procesin e automatizuar të bilancit të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike.

Menuja kryesore e programit kompjuterik duhet të shprehë zërat që lidhen me të dhënat kryesore të një klienti tarifor i lidhur dhe i furnizuar në TM ose TU, duhet që në SRM për çdo klient të sigurohen dhe të hidhen të dhënat kryesore që identifikojnë klientin dhe parametrat e tij.

OST sh.a. duhet të instalojë programe kompjuterike, të cilat realizojnë procesin e automatizuar të bilancit të shitjes dhe të blerjes, shkëmbimeve dhe transaksioneve të energjisë elektrike, si dhe të dhënat kryesore që identifikojnë përdoruesin dhe parametrat e tij.

Prodhuesit duhet të instalojnë programe kompjuterike të cilët realizojnë procesin e automatizuar të bilancit të shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike.

Gjithashtu kërkesat për energji elektrike do të jenë regjistruar dhe ruajtur në përputhje me standardet dhe procedurat e marrëveshjes së tregut të paraqitura në paragrafët në këtë Kod. Ruajtja e të dhënave, përputhja e leximeve të regjistruara dhe administrimi i situatave në rast defekti të pajisjeve matëse do të jenë në përputhje me rregullat e tregut ose në marrëveshjet midis palëve.

Të dhënat do të jenë të vlefshme edhe sipas rregullave të tregut dhe kodeve përkatëse të

transmetimit dhe të shpërndarjes. Në përgjithësi, të dhënat botohen në çdo kohë dhe zëvendësimi apo ndryshimi i tyre do të bëhet sipas kushteve dhe rregullave të vendosura në marrëveshjen midis palëve.

Sistemi i përpunimit të të dhënave protokollohet, ndërsa komunikimet e tyre do të jenë në përputhje me kushtet dhe rregullat e vendosura në marrëveshjen midis palëve dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Si rregull për çdo matës të regjistruar, të dhënat e tij do të ruhen në mënyrë informatike gjatë gjithë kohës së përdorimit të tij.

2.7.4 Leximi i tregimit të matësit

Tregimi i matësit do të lexohet dhe do të regjistrohet për çdo muaj për të realizuar bërjen e bilancit të energjisë elektrike (shitje-blerje, transaksione, shkëmbime).

Palët mund të bien dakord që leximi i tregimit të matjes të bëhet dhe në periudha të ndryshme, siç mund të përcaktohen në marrëveshjen midis tyre.

Në disa raste, ose me marrëveshje midis palëve leximi i tregimit të matësit mund të bëhet dhe në distancë (on-line).

2.7.5 Mosfunksionimi i sistemit të matjes

Në rast kur të dhënat e matjeve nuk janë të vlefshme, si rezultat i defekteve në pajisjet e komunikimit ose në sistemin qendror të të dhënave, atëherë do të përdoren të dhënat e marra nga pajisjet lokale të montuara te matësi (p.sh. regjistruesi lokal etj.).

Në rastet kur të dhënat nuk janë të vlefshme për shkak të defekteve dhe mosfunksionimit të matësit të vendosur në objekt, transformatorit të rrymës, të tensionit, kabllimit, pajisjeve mbrojtëse ose në rastet kur matësi i vendosur në objekt punon jashtë kufijve të lejuar të gabimit, atëherë marrja e të dhënave të matjes do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

2.8 Mbrojtja nga ndërhyrjet dhe dëmtimet

KSH, furnizuesit duhet të verifikojnë konsumin e energjisë elektrike të regjistruar në çdo pikë matje për të parë konsumin real të klientit fundor.

Në rast se zbulohen ndërhyrje dhe përdorime të paligjshme të energjisë elektrike, atëherë KSH, furnizuesit dhe organet kompetente duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në çdo rast që verifikohet që pajisjet e matjes ose një pjesë e tyre janë shkatërruar dhe dëmtuar ose nuk funksionojnë apo punojnë jashtë kufijve të lejuar të gabimit, atëherë merren masa për rregullimin, riparimin ose zëvendësimin e tyre ose të pjesëve të dëmtuara duke bërë të mundur kthimin në punë të pajisjes sipas kërkesave të lejuara.

Konsumatorët do të përdorin me kujdes dhe do t'i ruajnë pajisjet e matjes. Në rast se ata konstatojnë dëmtim të pajisjes matëse, atëherë duhet të lajmërojnë me shkrim subjektin që siguron (posedon) pajisjet e matjes sipas marrëveshjes për ta riparuar ose zëvendësuar.

2.9. Kërkesa ndaj përdoruesit dhe konsumatorëve fundorë

Çdo përdorues ose konsumator (klient) fundor duhet të lejojë që OST sh.a., KSH, furnizuesit, Policia Elektrike, punonjësit, inspektorët, agjentët, si dhe çdo person tjetër i autorizuar në bazë të legjislacionit në fuqi, kanë të drejtë të hyjnë në çdo objekt që ai ka në zotërim për konsumin e energjisë elektrike, me qëllim që të kontrollojë dhe të zbatojë rregullat dhe detyrimet sipas KMEE dhe legjislacionit në fuqi.

E drejta për të ndërhyrë sipas këtij paragrafi përfshin të drejtën e këtyre personave, për të kontrolluar, verifikuar kryerjen e punimeve të nevojshme etj. në territorin e përdoruesit ose konsumatorit për çdo matës ose pajisje matje, për zbatimin e KMEE dhe legjislacionit në fuqi.

2.10. Përbërja e Komisionit të Kodit të matjes së energjisë elektrike (KKMEE)

Përbërja e Komisionit do të jetë:

- Kryetari caktohet me konsensus nga kompania(të) shpërndarëse;
- Sekretari caktohet me konsensus nga kompania(të) e furnizimit;
- Një anëtar i cili përfaqëson OST sh.a.;
- Një anëtar i cili përfaqëson kompaninë publike të gjenerimit;
- Një anëtar i cili përfaqëson prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike;
- Një anëtar i cili përfaqëson të gjithë furnizuesit e kualifikuar;
- Një anëtar i cili përfaqëson klientët e kualifikuar;
- Një anëtar i cili përfaqëson interesat e klientëve tariforë.

Brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, kompania(të) e shpërndarjes, cakton(jnë)

kryetarin e KKMEE.

Kryetari brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, njofton të gjitha subjektet përbërëse të KKMEE për caktimin e përfaqësuesve të tyre pranë këtij Komisioni.

Brenda 15 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të gjitha subjektet janë të detyruara t'i dërgojnë përgjigje me shkrim kryetarit për caktimin e përfaqësuesit të tyre.

Komisioni do të krijohet brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi. Kryetari i këtij Komisioni do të thërrasë mbledhjen e parë në të cilën do të miratohet rregullorja e funksionimit të këtij Komisioni.

Vendimet e KKMEE do të merren me konsensus dhe do të dërgohen në ERE për miratim. Në qoftë se nuk arrihet konsensusi, çështja i kalohet për zgjidhje ERE-s. ERE shqyrton çështjen dhe merr vendim. Pas daljes së vendimit nga ERE njoftohen të gjitha palët për vendimin e dalë. Vendimi i ERE-s pasqyrohet në Kod, nëse gjykohet nga ajo se është pjesë e një modifikimi të Kodit.

Asnjë ndryshim i KMEE nuk do të zbatohet pa u miratuar në ERE.

2.11. Funksionet e KKMEE

Komisioni i Kodit të matjes do të kryejë funksionet e mëposhtme:

a) plotësimin e KMEE sipas vërejtjeve dhe këshillave që mund t'i sugjerohen Komisionit herë pas here nga ana e palëve, si dhe ia propozon ERE-s për miratim;

b) bën rekomandime dhe shtesa për KMEE, kur ai e gjykon të nevojshme duke dhënë dhe arsyet përkatëse dhe ia propozon ERE-s për miratim;

c) ndihmon në interpretimin e KMEE sipas kërkesave të bëra nga palët pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike;

d) merr në shqyrtim dhe konsideron objekt të aktivitetit të tij çdo ndryshim që konsiderohet i nevojshëm në KMEE për shkak të rrethanave të paparashikuara nga Kodi.

e) përshtat KMEE me udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe ia propozon ERE-s për miratim.

f) trajtimin e të gjitha rasteve të mosplotësimit të kushteve dhe standardeve të këtij Kodi të paraqitura nga palët dhe i propozon ERE-s argumentet përkatëse për shqyrtim.

2.12. Informacioni

Palëve do t'u sigurohet akses, për të parë çdo informacion në lidhje me matësit dhe pajisjet e matjes, në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve dypalëshe të KMEE dhe të legjislacionit në fuqi.

2.13. Njoftimi

OST sh.a, KSH, furnizuesit duhet të njoftohen nga ana e përdoruesve apo konsumatorëve për çdo ndryshim në pajisjet e matjes sipas rastit.

3. Kërkesat teknike

3.1. Hyrje

KMEE përcakton kërkesat teknike në lidhje me sistemin e matjes (pajisjet matëse) për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike në pikat e matjes.

3.2 Referencat

Për përcaktimin e standardeve dhe kushteve teknike të KMEE, si referim janë përdorur dokumentet e mëposhtme:

IEC Standard 60687 – Alternating Current Static Watt- Hour Meters for Active Energy (CI. 0.2S and 0.5 S);

- IEC Standard 61036 – Alternating Current Static Watt – hour Meters for Active Energy (CI.1 and 2);

- IEC Standard 61268 - Alternating Current Static Watt- Hour Meters for Reactive Energy (CI. 2 and 3);

- IEC Standard 60044 – 1 – Instrument Current Transformer ICT;

- IEC Standard 60044 – 2 – Instrument Voltage Transformers IVT;

- IEC Standard 60044 – 3 – Instrument Transformers - Combined Transformers;

- IEC Standard 61107 – Data Exchange for meter reating – direct local data exchange.

3.3 Pika e matjes

Pikat e matjes do të vendosen në kufijtë e pronës së klientit (konsumatorit), në kufijtë e përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe/ose siç parashikohet nga marrëveshjet e lidhura midis

palëve.

Pika e lidhjes mund të jetë e ndryshme nga pika e matjes dhe ky fakt është objekt miratimi i palëve në marrëveshje. Në këto raste, kërkesat e saktësisë për matjen do të zbatohen në pikën e matjes.

3.4 Standardet e pajisjeve të matjes

Të gjitha pajisjet e matjes do të jenë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e KMEE të përcaktuara në vazhdim. Këto kërkesa dhe kushte mund të rishikohen herë pas here nga Komisioni dhe miratohen nga ERE, me qëllim që të merret në konsideratë çdo ndryshim i teknologjisë apo kërkesave teknike, që lidhen me zhvillimin industrial si dhe standardet ndërkombëtare.

Çdo matës duhet të jetë i instaluar në një panel individual (boks individual) ose panel kolektiv (boks kolektiv ose panel). Paneli duhet të jetë i tillë që të mbrojë matësin nga lagështira, papastërtia, fushat elektromagnetike, goditjet fizike dhe të ruajë një temperaturë të përshtatshme. Paneli duhet të jetë i siguar dhe me vulosje të pamanipulueshme, me qëllim që të mos lejojë ndërhyrjet e paligjshme.

Matësit, në përputhje me IEC ose IEC 61036 (ose standardin europian ekuivalent), do të jenë të lidhur me transformatorët e rrymës dhe të tensionit.

Për realizimin e matjes, në rast se kërkohet, do të instalohen transformatorë rryme, në përputhje me IEC Standard 60044-1 (ose standardi ekuivalent Europian) dhe transformatorë tensioni në përputhje me IEC Standard 60044-2 (ose standardin ekuivalent europian), ose do të përdoren transformatorë të kombinuar të rrymës dhe tensionit, në përputhje me standardet e përshkruara në IEC Standard 6044 – 3/8.

Rekomandohet që si transformatorët e rrymës ashtu dhe ata të tensionit të jenë të siguar dhe/ose të vulosur. Nëse sistemi i matjes është me sistem telekomunikimi dhe aksesori të tjerë, duhet që edhe këto pajisje të vendosen në panelin e matjes dhe të jenë të siguar.

Të gjitha pajisjet e komunikimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardeve të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (International Telecommunications Union) (ITU) dhe rekomandimeve përkatëse për transmetimin e të dhënave në sistemin e telekomunikacionit.

Ruajtja e të dhënave do të bëhet brenda matësit ose jashtë tij nëpërmjet pajisjes së marrjes dhe ruajtjes së të dhënave. Në rastin e dytë matësi duhet të ketë një dalje të veçantë për të marrë vlerat e matura.

3.5 Saktësia dhe kufijtë e gabimit të pajisjeve të sistemit të matjes

Saktësia e pajisjeve të sistemit të matjes do të përcaktohet nga vlera e fuqisë së kërkuar në pikën e matjes. Kërkesat për saktësinë e pajisjeve të sistemit të matjes, duhet të marrin parasysh çdo ndryshim në të ardhmen të vlerave të fuqisë maksimale të kërkuar.

Klasa e saktësisë e bazuar në fuqinë maksimale të kërkuar (MVA) jepet në tabelën e mëposhtme.

Klasa e saktësisë				
Fuqia maksimale e kërkuar	> 50 MVA	10 – 50 MVA	1-10 MVA	< 1 MVA
Tr.rryme	0.2s	0.2s	0.5s	0.5s
Tr.tensioni	0.2	0.5	0.5	0.5
Matësit	0.2s	0.5s	1.0	2.0

Për matjen e energjisë elektrike aktive dhe reaktive pajisjet e sistemit të matjes do të jenë testuar dhe/ose kalibruar për të punuar brenda kufijve të lejuar të gabimit (siç paraqiten në tabelat e mëposhtme) duke marrë në konsideratë gabimet e transformatorëve të rrymës, tensionit, si dhe ato që shkatohen nga rezistenca omike e kabllit. Kabllot dhe kabllimi duhet të jenë të njohura dhe të përmbushin standardet ndërkombëtare.

Kushti	Kufijtë e gabimit të energjisë elektrike aktive sipas faktorit të fuqisë	
	Faktori i fuqisë	Kufijtë e gabimit në pikën e matjes
Rryma e shprehur si përqindje e vlerës të rrymës nominale		

10%÷120%	1	±1.0%	±1.0%	±2.0%	±3.0%
5% ÷ 10%	1	±1.5%	±1.5%	±2.5%	±3.5%
1% ÷ 5%	1	±2.5%	±2.5%	±3.5%	±4.5%
10%÷120%	0.5(-)	±2.0%	±2.0%	±3.0%	±3.5%
10%÷120%	0.5(+)	±2.0%	±2.0%	±3.0%	±3.5%

Kushti	Kufijtë e gabimit të energjisë elektrike reaktive sipas faktorit të fuqisë				
Rryma e shprehur si përqindje e vlerës të rrymës së matjes	Faktori i fuqisë	Kufijtë e gabimit në pikën e lidhjes			
10%÷120%	0	±0.4%	±4.0%	±4.0%	±4.0%
20%÷120%	0.866(-)	±5.0%	±5.5%	±5.0%	±5.0%
20%÷120%	0.866(+)	±5.0%	±5.5%	±5.0%	±5.0%

Të dhënat e drejtpërdrejta të testeve dhe të kalibrimit sipas kërkesave të mësipërme do të regjistrohen dhe do të ruhen në SRM.

Në rastet kur transformatorët ekzistues të matjes nuk janë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e KMEE-së, atëherë do të pranohet dhe zbatohet kushti:

- Kur ka ndryshime të mëdha të karakteristikave, atëherë do të instalohen transformatorë të rinj të matjes, në përputhje me kërkesat e KMEE-së.

3.6 Vulosja e sistemit të matjes nga OST sh.a.

Pajisjet e sistemit të matjes dhe ato të komunikimit do të jenë të instaluar në një panel të sigurt dhe të ndriçuar mirë ku mund të lexohen lehtë.

Paneli duhet të jetë i siguar dhe i vulosur nga palët. Kontrolli i vulosjes duhet të kryhet herë pas here nga përfaqësuesi i OST sh.a. Në rast se vula është e prishur, ajo duhet hequr dhe duhet zëvendësuar menjëherë.

Ndërhyrjet në pajisjet matëse dhe në pajisjet e komunikimit që i shoqërojnë ato, do të bëhet në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga OST sh.a në prezencë të përdoruesit.

Treguesi i matësit duhet të jetë gjithmonë i pastër dhe i dukshëm.

OST sh.a. do të kontrollojë vulat e matësve dhe pincat e vulosjes dhe do të mbajë një regjistër të veçantë për numrin dhe tipin e këtyre pincave, si dhe të personave që i kanë nën kontroll. Çdo vit OST sh.a. duhet të bëjë kontroll të gjendjes së pincave dhe të vulave.

3.7 Vulosja e sistemit të matjes nga KSH, furnizuesit

Pajisjet e sistemit të matjes duhet të jenë të instaluar në panel individual (boks individual), panel kolektiv (boks kolektiv) ose çele matje (kur matja kryhet në TM) të sigurt dhe të vendosura në ambiente të veçanta apo në vende ku mund të lexohen qartë, dhe lehtësisht të kontrollueshme nga përfaqësuesi të autorizuar nga KSH, furnizuesit. Në rastin kur matësi është i vendosur në bokse kolektive apo individuale të palexueshme, atëherë KSH/furnizuesi është i detyruar që të kryejë verifikimin e leximit të matësit dhe sistemit të matjes, në prani të klientit brenda 7 ditëve nga kërkesa me shkrim e këtij të fundit.

Pajisjet e sistemit të matjes duhet të jenë të vulosshme, duke i siguruar KSH-së, furnizuesit mundësinë për vulosjen e elementeve dhe kontakteve rrymë përcjellëse me vula.

Vulosja e makinerisë së aparatit matës bëhet nga prodhuesi (kur matësi është i ri) dhe në rastet kur ndërhyet në makineri nga KSH, furnizuesit me qëllim axhustimi, vulosja bëhet me vulë plumbi ose plastike nga laborator i autorizuar sipas kërkesave të këtij Kodi.

Vulosja e morseterisë së aparatit matës bëhet nga KSH, furnizuesit me vulë, duke qarkuar njëkohësisht dhe qarkun e makinerisë së matësit, në prezencë të klientit fundor ose të kualifikuar.

KSH, furnizuesit do të mbajnë dhe kontrollojnë pincat e vulosjes (laboratori matjes) duke e mbajtur në një regjistër të veçantë numrin dhe tipin e pincave.

Treguesi i matësit duhet të jetë gjithmonë i pastër dhe i dukshëm.

Ndërhyrjet në pajisjet e sistemit të matjes dhe vulat, do të bëhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga KSH-ja ose furnizuesit në prezencë të konsumatorit.

Periodikisht, KSH, furnizuesit duhet të ushtrojnë kontroll për vulosjen e sistemit të matjes, si dhe të gjendjes së pincave dhe vulave.

3.8 Karakteristikat e vulave

Vulat duhet të jenë me material special, i cili të sigurojë që vula të mos hapet në temperaturë nga -10 gradë deri në 120°C (kjo të shoqërohet me certifikatën e cilësisë) apo alternativë tjetër e dëmtueshme në mënyrë të pakthyeshme për ato temperatura. Vula nuk duhet të hapet as me mjete të tjera speciale pa u dëmtuar, në rast se bëhen përpjekje për manipulimin e vulës me qëllim vjedhjen e energjisë elektrike.

Vulat duhet të kenë të shkruar në njërën anë numrin e serisë me 6 shifra me relief të ngritur, kurse në anën tjetër të jetë stema e KSH, furnizuesit.

Vulosja bëhet me tel të viaskuar, i cili duhet të ketë thellësi viaske të mjaftueshme për mos shkëputjen e tij nga vula edhe në temperatura të larta.

4. Kërkesa teknike për konsumatorët fundorë

1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të matjes së energjisë elektrike

1.1 Sistemi i matjes së energjisë elektrike duhet të ndërtohet, të instalohet, të mirëmbahet dhe të operojë në përputhje me praktikën inxhinierike të industrisë së energjisë elektrike dhe standardet ndërkombëtare për të siguruar, aq sa mundësisht është e arsyeshme, vazhdimësinë e shërbimit, uniformitetin e cilësisë së shërbimit dhe sigurinë e personave dhe të pronës.

1.2 Kompanitë e shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizuesit duhet të zbatojnë kërkesat dhe kushtet teknike të vendosura në aktet e mëposhtme, si dhe në standardet ndërkombëtare, si:

Kodi shqiptar i matjes të energjisë elektrike, i miratuar nga ERE.

Kodi shqiptar i sistemit të transmetimit, i miratuar nga ERE.

Kodi shqiptar i sistemit të shpërndarjes, i miratuar nga ERE.

Kërkesat e standardeve IEC për matjen e energjisë elektrike dhe për instrumentet transformuese.

1.3 Çdo pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike duhet të adaptojë një program të inspektimit të sistemit të matjes, në mënyrë që të përcaktojë nevojat për zëvendësim dhe riparim. Frekuenca e inspektimeve të ndryshme duhet të bazohet në eksperiencën dhe në praktikat e mira të pranuar.

1.4 Çdo kompani shpërndarje e energjisë elektrike, furnizuesit duhet të ndërtojë (regjistrojë) një hartë, që tregon zonën e operimit të kompanisë shpërndarëse të energjisë elektrike, furnizuesit. Kjo hartë duhet të azhurnohet vit për vit, përveçse kur një azhurnim i tillë është i panevojshëm. Në një rast të tillë kompania shpërndarëse e energjisë elektrike, furnizuesit duhet të lajmërojnë ERE-n që harta e regjistruar është e pavlefshme. Harta, përveç kushteve të vendosura në licencë, duhet të tregojë:

a) Nënstacionet 110/TM kV;

b) Linjat nën 110 kV deri në 35 kV që administrohen nga kompania shpërndarëse

c) Kufijtë shtetërorë;

d) Kufijtë territorialë të përdorshëm.

1.5 Të gjitha të dhënat dhe hartat e përdorura që tregojnë pozicionin e të gjitha linjave të shpërndarjes, numrin dhe orientimin e tyre, qarqeve dhe transformatorëve të shpërndarjes duhet të ruhen në dosje. Këto të dhëna dhe ndryshimet përkatëse duhet të krijohen dhe të mbahen të azhurnuara brenda 6 muajve nga ndërtimi faktik.

2. Vendndodhja e matësve

2.1 Matësit jashtë objekti

a) Kur matësit janë instaluar jashtë objektit, ata duhet të vendosen jashtë ndërtesës, në mënyrë që të jenë të lexueshëm për personat e autorizuar për leximin e matësve, si dhe nga klientët.

KSH, furnizuesit do të jenë përgjegjës për testimin dhe mirëmbajtjen e matësve.

b) Matësit nuk duhet të instalohen në vende ku lexuesit e matësve ose njerëzit e shërbimit mund të dëmtojnë mjedisin, ose aty ku atyre do t'u duhet të kalojnë me vështirësi për të lexuar ose për të kryer shërbime të tjera matëse. Matësit nuk duhet të vendosen në vende ku ata mund të dëmtohen ose atje ku ata mund të shkaktojnë vështirësi, si për klientin ashtu dhe për kompaninë shpërndarëse, furnizuesit.

c) Në qoftë se matësi për arsye objektive nuk mund të vendoset jashtë objektit, atëherë ai

vendoset atje ku KSH, furnizuesit e gjykojnë të arsyeshme, në mënyrë që të plotësojë normat e këtij Kodi.

2.2 Matësi i vendosur në objekt (kryesor)

a) Matësit kryesorë janë të ndaluar të vendosen në ndërtesa që kanë më shumë se një njësi. Në ndërtesa të tilla kërkohen të vendosen matës të veçantë të kontrollit të energjisë elektrike për çdo njësi.

Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 2.3, matësit kryesorë mund të vendosen, dhe nuk kërkohen matës të veçantë, në rastet e mëposhtme:

i) Në ndërtesa banimi ku njësitë janë të dhëna me qira për më pak se 30 ditë.

ii) Në ndërtesa banimi ku një familje e vetme është ndarë për të krijuar njësi të reja.

iii) Në ndërtesa banimi ku nuk kanë pajisje elektrike të veçanta në njësi për qëllimet e mëposhtme:

- sipërfaqe ngrohjeje/ftohjeje;

- sipërfaqe midis apartamentesh etj.

iv) Në ndërtesa studentësh ose shkolla, kolegje dhe universitete.

v) Në ndërtesa tregtare ku një kompani ose firmë zë 70% ose më shumë të sipërfaqes së disponueshme.

vi) Në ndërtesa tregtare që nuk janë ndarë përfundimisht në njësi, por sipërfaqja është përcaktuar për çdo qiramarrës.

c) Matësit kryesorë janë të ndaluar të vendosen në shtëpi lëvizëse, dhe kërkohen matës të veçantë të energjisë elektrike për çdo shtëpi lëvizëse. Përfundimisht bëjnë shtëpitë e lëvizshme që janë të marra me qira për më pak se 30 ditë, për të cilat nuk kërkohen matës të veçantë.

d) Përfundimisht të tjera mund të lejohen me miratim të ERE-s në situata të veçanta, ku konstatohet që mosvendosja e matësit kryesor nuk do të jetë e përshtatshme.

2.3 Rivendosja e matësve

a) Kompania e shpërndarjes të energjisë elektrike, furnizuesit mundet që me dëshirën dhe me shpenzimet e tyre të rivendosin një matës kur mendon se është i nevojshëm.

b) Kompania e shpërndarjes e energjisë elektrike, furnizuesit do të rivendosin një pajisje matjeje për klientin sipas kërkesës së tij, ndërkohë që klienti do të paguajë koston e një shërbimi të tillë, të përcaktuar nga KSH, furnizuesit.

3. Pajisjet e testimit të matësve

3.1 Laboratori i matjes

a) Çdo kompani shpërndarje e energjisë elektrike ose çdo kompani furnizuese që mban ose vendos të mbajë një laborator matjeje, autorizohet, inspektohet dhe/ose çertifikohet sipas legjislacionit në fuqi.

b) Kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizuesit që nuk disponojnë laboratorë matjeje mund të autorizohen nga DPMK që të kryejnë teste në laboratorë të miratuar konform legjislacionit në fuqi.

3.2 Pajisjet e matjes

a) Çdo kompani shpërndarje e energjisë elektrike, furnizuesit që realizojnë shërbimin e matjes së energjisë elektrike duhet të sigurojnë dhe të kenë në gatishmëri instrumente testuese portabël të energjisë elektrike ose matës të vat-orëve brenda kufijve të përcaktuar në këtë Kod, si dhe tipe për testimin e shërbimit vat-orëve, matës të kërkesës, instrumente komutatore, matës të tensionit dhe instrumente të tjera elektrike në përdorim, sipas legjislacionit në fuqi.

3.3 Testet e matësve standard portabël

a) Për të testuar saktësinë e matësve portabël të vat-orëve, zakonisht të quajtur “matës standard portabël të vat-orëve” dhe instrumentet e tjera portabël të përdorur për matësit testues, çdo kompani shpërndarje e energjisë elektrike, furnizuesit e autorizuar nga DPMK, duhet të sigurojnë dhe të kenë të gatshme si referencë ose të kontrollojnë standardet e instrumenteve elektrike, matësit vat-orë, matësit e vatëve ose çdo pajisje tjetër të sistemit të matjes, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Matësit e kontrollit do të përdoren për kontrollin ose testimin e pajisjeve të matjes së energjisë elektrike.

4. Kërkesat për përpikmërinë e matësve vat-orë

4.1 Axhustimi i matësve

Matësit vat-orë duhet të axhustohen që të plotësojnë kërkesat e mëposhtme për përpikmëri përpara instalimit dhe pas testit periodik ose çdo lloj testi tjetër.

a) Çdo matës vat-orë që ka një regjistrim jokorrekt konstant ose që regjistron pa ngarkesë duhet të zëvendësohet ose të riparohet që të qëndrojë në shërbim.

b) Çdo matës vat-orë që ka një gabim në regjistrim më shumë se +2% ose -4% në ngarkesë të ulët, ose $\pm 2\%$ në ngarkesë të plotë, duhet të zëvendësohet ose mos lejohet të qëndrojë në shërbim pa u axhustuar. Kurdo qoftë një matës që kalon këto limite duhet të axhustohet.

c) Matësit duhet të axhustohen me gabim brenda normave të lejuara. Matësit nuk duhet të axhustohen për tolerancat e lejuara të gabimit.

5. Vendi dhe metodat për testimin e matësve

5.1 Të gjitha testet e matësve vat-orë duhet të bëhen me aparatura testimi të miratuara dhe në vende të autorizuar dhe/ose certifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Testet primare të matësve për instalim

6.1 Të gjithë matësat vat-orë të rinj do të testohen dhe axhustohen për t'u regjistruar me saktësi brenda limiteve të specifikuar në këtë Kod përpara instalimit.

6.2 Matësit vat-orë që janë në përdorim në qarqet e fuqisë së ulët do të testohen dhe rregullohen para instalimit për t'u regjistruar me saktësi brenda $\pm 2\%$, në 50% dhe në 100% të rrymës nominale.

6.3 Transformatorët e rrymës dhe të tensionit do të testohen për të përcaktuar raportin (koeficientin) dhe saktësinë e tyre. Të gjitha këto teste do të bëhen nga laboratorit i autorizuar ose i akredituar nga DPMK.

7. Testet periodike të matësve vat-orë

7.1 Të gjitha tipet e matësve dhe pajisjeve të matjes në pronat e konsumatorëve duhet të testohen, në përshtatje me rishikimin e fundit të standardeve të IEC për matësat e energjisë elektrike dhe paragrafët e mëparshëm të këtij Kodi.

7.2 Të gjithë matësit ose pajisjet e matjes në shërbim, që pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi, për të cilët nuk ka raport të testit të bërë brenda periudhës kohore të specifikuar për këtë kategori, duhet të testohen.

8. Testet sipas kërkesës së konsumatorëve

8.1 Çdo konsumator i energjisë elektrike ka të drejtë, pa pagesë, të bëjë një test saktësie të regjistrimit të matësit të energjisë elektrike sipas kërkesës së tij me kusht që:

a) Konsumatori nuk duhet të kërkojë më shumë se 1 test në 12 muaj;

b) Çdo kërkesë e konsumatorit për test brenda 12 muajve nga testi i mëparshëm do të paguajë koston e çdo testi, në qoftë se rezultatet e testit të matësit rezultojnë brenda klasës së saktësisë të përcaktuar në këtë Kod.

8.2 Për rezultatet e testit do të bëhet një raport përmbljedhës bazuar në kërkesën e konsumatorit.

a) Një kopje e këtij raporti dhe një relacion përmbljedhës do të mbahen në një skedar në zyrën e kompanisë të shpërndarjes së energjisë elektrike për një periudhë prej dy vjetësh.

9. Pasaktësitë e matjeve

9.1 Rregullimet për pasaktësitë e matjeve të energjisë elektrike do të kufizohen për periudhën e fundit 12-mujore dhe do të bëhen si më poshtë:

Sa herë që nga kompania shpërndarëse e energjisë elektrike, furnizuesit ose subjekte të tjera të autorizuar nga legjislacioni në fuqi, konstatohet se një matës e tejkalon klasën e saktësisë të përcaktuar në këtë Kod (si minus ashtu dhe plus), atëherë zbatohet procedura e mëposhtme:

i) Në rastet kur konsumatori ka paguar më shumë për shkak të gabimit në matje mbi kufijtë e lejuar të gabimit, atëherë kompania e shpërndarjes, furnizuesit detyrohen t'i rimburojnë vlerën konsumatorit për 12 muajt e fundit. Rimbursimi do të bëhet ose me korrigjim të faturës së ardhshme mujore të konsumatorit deri në shlyerjen e plotë të gabimit të konstatuar, ose si një pagesë e shumës totale brenda 45 ditëve të konfirmimit të matjes (faturimit) të pasaktë. Për mënyrën e dytë të rimbursimit duhet të bien dakord kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe konsumatori të ndarë në disa këste ose ta paguajë atë totalisht njëherësh.

ii) Në rastet kur konsumatori ka paguar më pak për shkak të gabimit në matje mbi kufijtë e

lejuar të gabimit, atëherë konsumatori detyrohet të paguajë vlerën e mbetur për 12 muajt e fundit. Pagesa do të bëhet ose me korrigjim për faturën e ardhshme mujore të konsumatorit deri në shlyerjen e plotë për gabimin e konstatuar, ose si një pagesë e shumës totale brenda 45 ditëve të konfirmimit të matjes (faturimit) të pasaktë. Për mënyrën e dytë të rimbursimit duhet të bien dakord kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizuesit dhe konsumatori të ndarë në disa kështe ose ta paguajë atë totalisht njëherësh.

10. Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i rrugës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren “18 Shtatori” në qytetin e Gjirokastrës”

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Gjirokastrë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS DHE REHABILITIMI I KANALIZIMEVE NË SHËTITOREN “18 SHTATORI” NË QYTETIN E GJIROKASTRËS

1. Për truallin

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Shënime
1	Reiz Fiqo Ruca	350 m ²	3500	1 225 000	
2	Reiz Fiqo Ruca	50 m ²	3500	175 000	
3	Bashkëpronarët	280.9 m ²	4000	1 123 600	
	Spartak Hoxha				
	Gjergj Hoxha				
	Leonard Hoxha				
	Etleva Hoxha				
	Qerim Hoxha				
	Sabihe Hoxha				
	Ylber Hoxha				
	Kreshnik Hoxha				
	Elsa Mezini				
	Aurel Hoxha				
	Nedin Hoxha				
	Bajram Hoxha				
	Afërdita Sinani				
	Kastriot Hoxha				
	Fatmira Hoxha				
	Flutura Shaba				
4	Tatjana Agim Shabani	72 m ²	5952	428.544	
5	Ibrahim Kasem Buzheri	143.1 m ²	4000	572.400	
6	Jani Ruxho	4 m ²	3500	14.000	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim pronësie
	Totali			3 538 544	

2. Për objektin

Nr.	Emri	Emërtimi	Vlera në lekë	Shënime
1	Tatjana Agim Shabani	lokal sip. 72 m ²	6 426 588	
2	Ibrahim Kasem Buzheri	shatërvan	807 811	
3	Jani Ruxho	lokal 4 m ²	100 596	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim pronësie

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 15.4.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë